



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008 si dhe nenit 3 të Udhëzimit administrativ (MASHT) Nr.02/2016 për aktivitetet jashtëshkollore, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. NDALOHET, organizimi i mbrëmjeve të semimaturës, për nxënësit e klasëve të IX-të nga ana e të gjitha Institucioneve edukativo arsimore të Komunës së Lipjanit.

II. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Arsim i Komunës së Lipjanit.

III. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Baza ligjore për nxjerrjen e këtij Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008 si dhe Udhëzimit administrativ (MASHT) Nr.02/2016 për aktivitetet jashtëshkollore.

Ndalimi i organizimit të mbrëmjes së semimaturës, për nxënësit e klasëve të IX-të bëhet duke u bazuar se jemi në periodën e përfundimit të vitit shkollor dhe Drejtoratit Komunal të Arsimit i janë drejtuar një numër i Drejtorëve të Shkollave për organizimin e mbrëmjes së semimaturës për nxënësit e klasëve të IX-të pasi që lejimi i organizimit të mbrëmjeve të tilla jashtë objekteve shkollore dhe në orët e mbrëmjes është në kundërshtim me dispozitat e Udhëzimit administrativ (MASHT) Nr.02/2016 për aktivitetet jashtëshkollore.

Nga të cekurat më lartë të gjitha institucionet edukativo arsimore edhe në këtë përfundim të vitit shkollor janë të obliguara t'iu përmbahen dispozitave të nenit 3 të Udhëzimit administrativ (MASHT) Nr.02/2016 për aktivitetet jashtëshkollore, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

1Nr. Q10-39544

Lipjan, më 14.06.2019

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

